



**Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim/Direktorat za Javne Usluge,
Infrastrukturu i Stanovanje/Department of Public Services, Infrastructure and Housing**

08.nr.343- 508 /24; dt: 02.05.2024;

Gjilan

Duke u bazuar në nenin 62.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në nenin 37 paragrafi 1 pika 1,6 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01.nr.16-126211 dt.06/11/2014 dhe Ndryshimet dhe plotësimet ne Statutit, 01.nr.016-28448 të dt: 22.03.2018 dhe në zbatim të dispozitave të nenit 6, nenit 15.2 paragrafi 2.1, neni 14, nenit 17 paragrafi 7, dhe nenin 18, 19 dhe 20 të Ligjit nr. 04/L-179, për Transportin Rrugor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr.21/13 Qershor 2013), Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim e Komunës së Gjilanit lëshon këtë :

SH P A L L J E

PËR REGJISTRIMIN E VIJAVE URBANO-PERIFERIKE PËR KËTO RELACIONE:

Nr.	Emërtimi i vijave me autobus/minibus	Numri i nis.& kth. ≤
1	Gjilan -Vërbicë e Kmetocit dhe anasjelltas	5
2	Gjilan - Shillovë dhe anasjelltas	5
3	Gjilan - Shillovë (serbe) dhe anasjelltas	5
4	Gjilan - Capar-Bukovik dhe anasjelltas	9
5	Gjilan – Pogragjë - Llovcë dhe anasjelltas	4
6	Gjilan – Pogragjë - Stublinë dhe anasjelltas	5
7	Gjilan - Llashticë dhe anasjelltas	10
8	Gjilan – Lladovë - Nasalë dhe anasjelltas	5
9	Gjilan - Cërrnicë dhe anasjelltas	8
10	Gjilan - Vrapçiq dhe anasjelltas	5
11	Gjilan - Livoq i Epërm dhe anasjelltas	4
12	Gjilan - Zhegoc Verbicë e Zhegocit dhe anasjelltas	5
13	Gjilan - Ponesh- Gadish- Kishnapole- Sllakove dhe anasjelltas	5

KUSHTET

Kompanitë për të ushtruar veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve me autobus/minibus duhet plotësuar këto kushte:

- Kompania të jetë e regjistruar në MTL,
- Të kenë selinë në territorin e Komunës së Gjilanit,
- Të ketë automjetet në pronësi të vet,
- Autobusët nuk mund të kenë vende për qëndrim në këmbë,
- Të ketë autoparkun pronë e tij ose të kontraktuar me qira,
- Ngasësit e automjeteve të jenë në marrëdhënie pune (kontratë) pranë kompanisë dhe t'i plotësojnë kushtet e parapara për vozitës autobusi.

- Të ketë të punësuar së paku katër punëtorë (dy vozitës profesional, mekanik - elektrikist dhe punëtor administrativ);
- Të ketë në pronësi minimum dy automjete transporti (autobus/minibus),
- Çertifikimi për plotësimin e kushteve teknike për autobus ku i njejtë vlenë 3 (tre) vite nga data e lëshuarjes nga DSHPIB-ja;
- O.T. që është i pajisur me RU nga DSHPIB-ja në periudhën 2024 - 2027 nuk mund të aplikojnë;
- O.T. obligohet që çdo fletë të aplikacionit ta vulos dhe të mbyllur në pliko ta dorëzoj.

Kërkesës /aplikacionit - t'i bashkangjitet:

- Çertifikimi-et për plotësimin e kushteve teknike të automjetit-eve autobus/minibus, i lëshuar nga DSHPIB-ja, me afatë të vleshmërisë
- Pëlqimi për plotësimin e kushteve teknike të autoparkut, i lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike;
- Lejet e vozitjeve për ngasësit (fotokopje),
- Letërnjoftimin e pronarit të ndërmarrjes (fotokopje) dhe çertifikata e biznesit,
- Listën për linjat që konkurron, së bashku me orarin dhe rendin e udhëtimit të propozuar nga DSHPIB-ja.
- Dëshmi nga Drejtoria e Inspeksionit që nuk është zhvilluar kundërvajtje ndaj kompanisë gjatë viteve 2021-2024.
- Dëshmi nga ATK-ja që nuk ka obligime tatimore për 2023;
- Operatori transportues nuk mund të aplikoj në më shumë se 2 (dy) relacione.

Poentimi i ofertave do të bëhet sipas këtyre kriterëve:

- Kushtet teknike të automjetit sipas vjetërisë në %,
- Mbarëvajtja e rendit të udhëtimit % dhe
- Përparësi e operatorit lokal në %.

Kërkesa/Aplikacioni me dokumentacion përcjellëse mund të tërhiqet në Q.SH.Q Kati i I-rë, te Soliteri, ose në DSHIB i cili dokumentacion pas kompletimit dorëzohet gjithashtu në Q.SH.Q, në pliko të mbyllur në këtë adresë.

Adresa:

Komuna e Gjilanit - Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim Gjilan, rruga "Ibrahim Rugova". P.n. Gjilan.

Gjatë tërheqjes së aplikacionit nga operatorët duhet të paguajnë një taksë në shumë prej **50:00 €**.

Afati për paraqitje të kërkesave është i hapur deri më 31 Maj 2024, në ora 13:00, kur edhe do të bëhet hapja e aplikacioneve ora 13:15 nga ana e komisionit.

Gjilan, më 02.05.2024



**Komuna e Gjilanit
DSHIB Gjilan**

Drejtori/ Mentor Mihovci/